

V E N D I M
Nr.342, datë 3.7.1995

PËR TARIFAT PËR PËRDORUESIT E PRONËSISË ARTISTIKE

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në kontratën që lidhet ndërmjet agjencive të autorëve dhe përdoruesve të pronësisë artistike për kalimin e të drejtave në lidhje me përdorimin e pronësisë në bazë të ligjit nr.7564, datë 19.5.1992, ndryshuar me ligjin nr.7923, datë 19.4.1995, të përcaktohen tarifat që përdoruesit e pronësisë artistike duhet t'i paguajnë agjencive të autorëve në rastet e përdorimit të pronësisë artistike.

2. Palët kontraktuese t'i përmbahen këtyre tarifave orientuese për përdorimin sipas rastit të pronësisë artistike në:

a) Kanalet e televizionit shtetëror: 2,5 për qind - 4,8 për qind të të ardhurave nga financimi buxhetor për shpenzimet operative, nga të ardhurat e sponsorizimeve, të reklamave, shpërndarja e mesazheve dhe çdo e ardhur tjetër që lidhet me difuzionin në fushën e kulturës e të artit.

b) Radio shtetërore: 3 për qind - 4,5 për qind të të ardhurave nga financimi buxhetor, nga sponsorizimet, reklamat, shpërndarja e mesazheve dhe çdo e ardhur tjetër që lidhet me difuzionin në fushën e kulturës e të artit.

c) Radio lokale: 2 për qind - 2,8 për qind të të ardhurave nga financimi buxhetor, nga sponsorizimet, reklamat, shpërndarja e mesazheve dhe çdo e ardhur tjetër që lidhet me difuzionin në fushën e kulturës dhe të artit.

ç) Kanalet televizive private: 3 për qind - 4,5 për qind të të ardhurave për veprimtaritë kulturore plus të të ardhurave nga reklamat, sponsorizimet, shpërndarja e mesazheve dhe çdo e ardhur tjetër që lidhet me veprimtaritë kulturore.

d) Stanacionet e radiove private shqiptare ose brenda territorit shqiptar: 2 për qind - 4 për qind të të ardhurave për veprimtaritë kulturore, si dhe për të ardhurat nga reklamat, sponsorizimet, shpërndarja e mesazheve dhe çdo e ardhur tjetër që lidhet me veprimtaritë kulturore.

dh) Sallat private për shfaqje muzikore, variete, si dhe studime, në rastet kur jepen shfaqje muzikore dhe variete nga trupa private: 4 për qind - 5 për qind të arkëtimit të biletave të shitura.

e) Diskoteka, klube nate, piano-bare, restorante me pistë për vallëzim: Vlera e çmimit mesatar të një pieje alkoolike për ditë pune për lokalet deri në 30 vende. Për lokalet mbi 30 vende kësaj vlere i shtohet përqindja mbi numrin 30.

ë) Restorantet dhe kafenetë: Vlera e çmimit të një kafeje në ditë pune për ato që nuk kanë vende ulur dhe ato me deri në 30 vende ulur; për ato me mbi 30 vende ulur, vlera e çmimit të një kafeje plus përqindjen mbi 30 vende ulur.

f) Salla të shfaqjeve kinematografike private: 2 për qind - 2,5 për qind të arkëtimit të biletave të shitura.

g) Teatrot dramatike dhe teatrot e kukllave: 1,5 për qind - 2 për qind të arkëtimit të biletave të shitura.

gj) Mjete transporti (tren, anije, autobusë, avionë): 0,1 për qind të çmimit të biletave të shitura.

h) Hotelet, motelet private që përdorin muzikë, kur kanë kafënë, disko, restorante etj., zbatohen tarifat e përcaktuara më sipër.

i) Regjistrimi i kasetave, videokasetave, kompaktdisqeve: 7 për qind - 10 për qind të çmimit të shitjes me pakicë.

j) Sektorët e prodhimit ose importit të kafestave, videokasetave a kompaktdisqeve të regjistruara: 4 për qind - 5 për qind të çmimit të shitjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi